

Microsoft ka lëshuar një azhurnim jashtë afatit normal të azhurnimit të "patch"-ve për rregulluar dobësitë për një shumëllojshmëri të produkteve të kompanisë që përdorin platformën e zhvillimit të programeve C ++ dhe librarinë API të Autodesk FBX.

Dobësitë e vlerësuara me rëndësi janë mbuluar nga CVE-2020-7080, CVE-2020-7081, CVE-2020-7082, CVE-2020-7083, CVE-2020-7084 dhe CVE-2020-7085.

Këto mund të çojnë në ekzekutimin e kodit në distancë nëse shfrytëzohen nëpërmjet përpunimit me përmbajtje 3D të krijuar posaçërisht nga sulmuesi. Nëpërmjet një sulmi të suksesshëm sulmuesi mund të fitojë të njëjtat të drejta si përdoruesi lokal, megjithatë përdoruesit e llogarive të të cilëve janë konfiguruar të kenë më pak të drejta përdorimi në sistem mund të ndikohen më pak se përdoruesit që veprojnë me të drejtat e përdoruesit administrativ.

Produktet e prekura janë versionet 32- dhe 64-bit të Microsoft 2019, Office 365 ProPlus dhe Paint 3D.

"Patch"-t për ndreqjen e këtyre vulnerabiliteteve i gjeni në linkun e mëposhtëm:
<https://portal.msrc.microsoft.com/en-US/security-guidance/advisory/ADV200004>